

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep (nr.yinë ark.08-4626/1 datë 14.12.2023), deklaratat (e noterizuara) nga drejtuesi i televizionit UZP nr.1284/2023 datë 28.12.2023, dhe nga themeluesi/pronari i vetëm i televizionit SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep UZP nr.1283/2023 datë 28.12.2023 dhe konkluzionin me nr.ark.0201-125/3 datë 11.1.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur më 11.1.2024 miratoi:

Aktvendim për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, është posedues i lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-117 datë 7.9.2023, (me vlefshmëri nga 5.1.2024 deri më 4.1.2027), i cili transmeton program nëpërmjet radiofrekuencane, në nivel lokal në zonën e komunës së Prilepit.

Më datë 14.12.2023 SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje me transmetim të programit në radio nr.yinë ark.08-4626/1 datë 14.12.2023, me të cilën e ka njoftuar Agjencinë se SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep do të punojë dhe do të transmetojë program në radio deri më 31.12.2023, përkatësisht nga data 1.1.2024 do të ndërpresë transmetimin e programit në radio. Në lidhje me njoftimin e cituar, Agjencia më 15.12.2023, në adresën zyrtare të postës elektronike të transmetuesit e regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të RMV-së, njoftoi transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzon deklaratat të noterizuara nga drejtuesi i transmetuesit dhe nga themeluesi/pronari i vetëm i SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, ku detyrimisht duhet theksuar se nga 1.1.2024, ndërprehen me transmetim të programit në radio.

Më datë 28.12.2023, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë nga SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, është dorëzuar deklaratë ark.nr.08-4626/2 datë 29.12.2023, nga drejtuesi (e noterizuar) i transmetuesit, UZP nr.1284/2023 datë 28.12.2023, dhe nga themeluesi/pronari i vetëm (e noterizuar) të SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, UZP nr.1283/2023 datë 28.12.2023, me të cilin deklarohet se SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep nga data 1.1.2024, ndërprehen së transmetuari programin në radio.

Transmetuesi në fjalë nuk ka (posedon) borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ose televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratë me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio dhe televizion. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi 2).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (20 të LSHMAAV, si dhe deklaratat me shkrim të lartpërmendur dhe të noterizuara, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep nga regjistri i transmetuesve.

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, Deklaratat (e noterizuara) nga drejtuesi i transmetuesit UZP nr.1284/2023 datë 28.12.2023 dhe nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep UZP nr.1283/2023 datë 28.12.2023, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe konkluzionin ark.nr.0201-125/3 datë 11.1.2024, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.